

Drejtuar: Z. Petrit AHMETI
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Lënda: Plotësim dokumentacioni për miratimin e tarifës së gazit natyror

I nderuar Z. Ahmeti,

Shoqëria Albgaz Sh. a realizon objektin e veprimtarisë së saj sipas Ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror".

Me Vendimin Nr. 848, datë 07.12.2016, për "Krijimin e Shoqërisë "Albgaz" Sh.A. dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të Shoqërive Albpetrol Sh.A. dhe Albgaz Sh.A.", Këshilli i Ministrave, ka krijuar autoritetin publik që është përgjegjës për trasmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, e cila është Shoqëria "Albgaz" Sh.A.

Në bazë të Vendimit të bordit të ERE-s Nr.20, datë 19.01.2018 "*MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAZ SH.A PËR VITIN 2018*" dhe në vijim të shkresës suaj Nr.13/1 Prot., datë 26.01.2018, Lënda: "*Kërkesë për plotësim dokumentacioni lidhur me aplikimin e ALBGAZ sh.a mbi kërkesën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror*", shoqëria Albgaz sh.a ju sqaron si vijon:


Vijomë me plotësimin e dokumentacionit:

- Aplikimi duhet të plotësohet me analiza dhe argumenta për të gjitha shpenzimet operative të vitit ushtrimor të mbyllur, duke dërguar në ERE pasqyrat financiare paraprake për vitin 2017.
- **Shpenzimet**

Shpenzimet në Programin e Zhvillimit Ekonomik janë të ndara në dy nënkategori, Shpenzimet Variabël dhe Shpenzimet Konstante. Organigrama e Shoqërisë është e pandryshuar, me një numër total punonjësish prej 117 veta me pagë mesatare prej 56,695 ALL. Sipas organikës në të njëjtën linjë me 2017, në vitin 2018 Shoqëria do të operojë përmes strukturës si në vijim: Drejtoria Teknike, Drejtoria e Projekteve dhe

Marrveshjeve, Drejtoria e Financës Kontabilitetit dhe Programimit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, dhe Drejtoria e Marrveshjeve Tregëtare.

Aktiviteti i Shoqërisë Albgaz sh.a. për vitin 2017 Shpërndarja e shpenzimeve totale për vitin 2017 është paraqitur në diagramën si në vijim.



Bazuar në negociatat e fundit me TAP AG dhe projektin e IAP-it, trajnimi i stafit të Drejtorisë Teknike dhe Sektorit të Projekteve do të jetë ndër pikat kyce të vitit të ardhshëm. Sistemi i linjave të transmetimit dhe së gazit në Shqipëri është ende në proces evidentimi, pasi linjat e vjetra janë administruar dhe mirëmbajtur jashtë standarteve. Kjo sjell nevojën e investimeve në terren, por edhe paraqet një shpenzim për humbje konstante në rrjetin e transmetimit. Sasia e gazit në hyrje të linjave nuk është e njëjtë me atë në dalje dhe kjo paraqet sfidën primare të Shoqërisë, një sistem funksional transmetimi gazi në tregun Shqiptar.


Në vijim të llogjikës së mësipërme, stafi i Drejtorisë Teknike dhe i Sektorit të Projekteve do të jenë subjekt për trajnime të vazhdueshme mbi teknikat më të fundit për mirëmbajtje dhe operim linjash. Trajnimi i stafit do të sigurojë në të ardhmen uljen e shpenzimeve për mirëmbajtje nga shoqëri të treta ose koncensionarët, si dhe do të sigurojë të ardhura të drejtpërdrejta duke patur për qëllim final marrëveshjen për mirëmbajtjen e linjave të TAP AG.

Zë i ri shpenzimi krahasimisht me vitin e kaluar është përfshirja e Materialeve Promocionale si dhe Marketingu. Me kërkesë të Departamentit të Marrdhënieve me Publikun, do të caktohet fond për pjesmarrjen

e Albgaz sh.a. në panairë dhe ekspozita në mënyrë që të promovohet aktiviteti tregëtar. Panairë si Energy Expo & Forum, Tirana Albania, mbledhin në një godinë shoqëri të interesuara për shërbimet e ofruara nga fusha e energjistikës. Pjesmarrës të përhershëm janë si banka të ndryshme me kapital vendas ose të huaj, shoqëritë e shërbimeve publike (i.e. OSSHEE, KESH, OST, AKBN). Paraqitja e alternativës së shfrytimit të gazit për gjenerimin e energjisë është ide e re në tregun vendas. Zgjerimi i aktivitetit është i domosdoshëm për Albgaz sh.a. prandaj dhe duhet të krijojë mundësi për organizim e pjesmarrje konferencash ku të ketë mundësi të promovojë aktivitetin dhe shërbimet që ofron.

Marketingu promocional do të konsistojë në promovimin e shërbimit të transmetimit duke ofruar kontrata tërheqëse subjekteve të industrisë, për t'i stimuluar të ndërrojnë mënyrën e furnizimit me energji. Një plan i gjërë paraprak i stimulimit të kërkesës duhet ndërmarrë me qëllim që investimet infrastrukturore të kenë një normë kthimi të pranueshme. Studimi i nevojave të tregut dhe parashikimi i investimeve urbane në rajonin e synuar (Fier-Vlorë; Tiranë-Durrës) përbën parakusht për procedimin e praktikave të promovimit dhe nxitjes publike për gazin natyror. Komunikimi me publikun pasqyron vizionin, identitetin dhe qëllimet e kompanisë në këtë sektor dhe mirëmban, zhvillon apo krijon marrëdhënie afatgjata dhe konstruktive me aktorët e interesuar apo të prekur nga veprimtaria e shoqërisë sonë.

Shperndarja e Shpenzimeve te Parashikuara per vitin 2018



- Shpenzimet per pagat
- Shperblime K. Mbikqyres
- Te tjera konstante
- Energjia elektrike
- Shpenz.Zhdem,Rregull,Pastr.Mjedisi
- Humbje ne Rrjetin e Transmetimit
- Sigurimet shoqerore (16.7%)
- Amortizimi
- Shpenzime materiale dhe sherbime
- Sherbime nga te trete - Mirembajtje
- Shpenzime Administrative

Zerat e Detajuar te Shpenzimeve 2018

<i>Shpenzimet per pagat</i>	000, L	95,800
<i>Sigurimet shoqerore (16.7%)</i>	000, L	15,999
<i>Shperblime K. Mbikqyres</i>	000, L	2,052
<i>Amortizimi</i>	000, L	11,500
<i>Ndihma per semundje e fatkeqsi</i>	000, L	200
<i>Karburant</i>	000, L	1,600
<i>Lubrifikant</i>	000, L	817
<i>Pjese kembimi per mak-paisje</i>	000, L	2,951
<i>Te tjera materiale dhe sherbime</i>	000, L	400
<i>Energjia elektrike</i>	000, L	9,200
<i>Sherbime nga te trete</i>	000, L	7,000
<i>Shpenzime.Zhdentim /Rregullim / Mjedisi</i>	000, L	1,000
<i>Dieta Udhetimi</i>	000, L	4,000
<i>Kancelari</i>	000, L	1,400
<i>Shpenzime te tjera (pritje percjellje/Licencim/Projektim /EKR etj)</i>	000, L	5,200
<i>Shpenzime bankare</i>	000, L	100
<i>Shpenzime telefoni</i>	000, L	880
<i>Shpenzime Gjyqi e noterie</i>	000, L	2,684
<i>Shpenzime per kualifikim,</i>	000, L	10,500
<i>Tatim pasurie,taksa,siguracion</i>	000, L	1,200
<i>Mirembajtje Zyra</i>	000, L	400
<i>Shpenzime Mjekesore</i>	000, L	200
<i>Vleresim Mjedisor</i>	000, L	1,500
<i>Shpenzime Qera</i>	000, L	8,400
<i>Inventar I Imet</i>	000, L	820
<i>Materiale Promoc dhe Spenz Marketingu</i>	000, L	1,500
<i>Informatizim</i>	000, L	880
<i>Humbje ne rrjet</i>	000, L	1,400

- Duhet të paraqiten analiza të detajuara mbi nivelin e propozuar të të gjithë elementëve përbërës të kostove operative konform nenit 7 dhe nenit 8 të Metodologjisë, për periudhën e ardhshme 2018. Pavarësisht deklaramit tuaj se nuk ka histori të shpenzimeve dhe të dhënat janë të limituara do të duhej që shifrat e propozuara prej jush të mbështeten me argumenta përkatëse për parashikimin e elementeve të tillë si: humbjet në rrjetin e transmetimit, shpenzimet materiale, energji elektrike e karburant etj.
 - Aplikimi duhet të plotësohet me analizat e llogaritjeve të Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) për vitin 2017 për të evidentuar dhe paraqitur në këtë mënyrë gjendjen dhe lëvizjet e asetëve të krahasuara me pasqyrat financiare përkatëse. Ju kujtojmë që aplikimi për tarifë duhej të paraqitej nga Plani i Investimeve të vitin 2018.
 - Norma e kthimit mbi kapitalin (WACC), në zbatim të formulës përlllogaritëse të nenit 10 të metodologjisë.

➤ Përlllogaritja e ROC dhe e variablave të saj

Në draft-metodologjinë e përlllogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror, është përcaktuar formula për përcaktimit të kthimit të lejuar të kapitalit. Formula bazë është si në vijim:

$$ROC = RAB * WACC$$

RAB përfaqson Bazën e Rregulluar të Aseteve

WACC përfaqson Koston Mesatare të Ponderuar të Kapitalit

Në bazë të Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Planit të biznesit për vitet e ardhshme, janë marrë të dhënat bazë të domosdoshme për të përkthyer elementët e mësipërm në vlera sa me reale. Shoqëria Albgaz Sh.a. është kompani me kapital 100% shtetëror. Kapitali dhe asetet e vëna në dispozicion është zbatuar në përputhje me VKM Nr. 848 datë 07.12.2016 për "Krijimin e Shoqërisë Albgaz Sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol Sh.a. dhe Albgaz Sh.a." dhe sipas Udhëzimit Nr. 550/1 datë 02/02/2016 për "Zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë Albpetrol Sh.a." me listën e asetëve të cilat shërbyen për krijimin e Qendrës së Transmetimit/Shpërndarjes së Gazit, tashmë shoqëri më vete Albgaz sh.a.. Për sa më sipër është realizuar nga EKR të kontraktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lista me asetet e prekura nga ndryshimi si dhe vlerësimi i vlerës së mbetur të tyre. Shoqëria Albgaz Sh. a e ka marrë për bazë këtë vlerësim zyrtar për bilancin e celjes së shoqërisë. Totali i asetëve sipas vlerësimit është në shifrën 827'797'158 Lekë, ku përfshihen toka, ndërtesa, tubacione dhe instalime, makineri dhe pajisje si dhe inventar i imët.

Për qëllimin përfundimtar përlllogaritjen e tarifës së transmetimit të gazit, nuk do të merret shuma totale e asetëve të shoqërisë, por vetëm kategoria që lidhet me operimin e rrjetit. Baza e Rregulluar e Asetëve do të përlllogaritet në bazë të formules:

$$RAB = RV + CA + L + AUC - P - TP - OL$$

Perlogaritja e Variablit RAB

Lista e Aseteve Operacionale per Transmetim										
Nr		(L)	(RV)	(CA)	(AUC)	(P)	(AP)	(TP)	(OL)	Vlera e Aseteve
1	Stacion Gazi Ballsh									7,570,213
	Truall (L)	6,342,105								
	Objekte (RV)		1,228,108							
2	Stacion Gazi Fier									99,585,744
	Truall (L)	98,000,000								
	Objekte (RV)		1,585,744							
3	Stacion Kompresor Drenove									4,909,044
	Truall (L)	2,476,000								
	Objekte (RV)		2,433,044							
4	Tubacione (RV 1)									247,779,793
	<i>Lidhje Teknologjike</i>		6,066,513							
	<i>Tubacion Gazi 6" Ballsh Usoje 1.2 km</i>		1,189,513							
	<i>Tubacion Gazi 12" Ballsh Fier 24 km</i>		31,720,332							
	<i>Tubacion Gazi 3-6-8" Ballsh Delvine 101 km</i>		130,867,115							
	<i>Tubacion Gazi 10" Ballsh Drenove 5.5 km</i>		14,396,627							
	<i>Gazsjelles Frakull Fier 7 km</i>		12,988,637							
	<i>Tubacion Gazi 12" Fier Potez 3.5 km</i>		10,911,794							
	<i>Gaznadres</i>		1,392,153							
	<i>Ndares Gazi</i>		696,077							
	<i>Tubacion Uji Ø 4"</i>		2,967,766							
	<i>Zevendesim Tubacion Uji Kompresore</i>		1,280,138							
	<i>Lidhje Teknologjike</i>		8,352,919							
	<i>Tubacion Magjstral Gazi</i>		24,273,439							
	<i>Lidhje Teknologjike</i>		649,672							
	<i>Tubacion Magjstral uji Ø Komp</i>		27,098							

5	Makineri Pajisje (CA)			30,911,387						30,911,387
	Nentotal	106,818,105	253,026,689	30,911,387	-	-	-	-	147,000,000	
TOTAL - Baza e Rregulluar e Aseteve										243,756,181

Sipas të dhënave të paraqitura në raportin e Ekspertes Kontabël, janë shpërndarë vlerat e Stacioneve të gazit që përmbajnë truall dhe objekte, Tubacione (të cilat përbëjnë pjesën më të rëndësishme të asetëve të shoqërisë), Makineri Pajisje dhe Inventar I Imët. Sipas tabelës këto vlera janë kategorizuar si RV (vlera e mbetur e asetëve fikse të trupëzuara të nevojshme për operimin e rrjetit), L (vlera e tokës) si dhe CA (active qarkulluese të nevojshme për operimin e rrjetit). Vlera e asetëve në total është 810'517'178 Lekë, dhe për të kuptuar vlerën e RAB duhet zbritur vlera e OL (të tjera të pagueshme deri në masën e fondeve në dispozicion të operatorit të rrjetit dhe që mbi të cilat nuk ka interes). Fondet në dispozicion të shoqërisë përfshijnë huatë e marra pranë Albpetrol sh.a. si dhe OST sh.a., pa aplikimin e interesave.

Ndërkohë në tabelën për përlllogaritjen e bazës së rregulluar të asetëve, disa element mbanin vlerën 0 Lekë. AUC (parapagimet dhe asetet në ndërtim/investimet në process) është me vlerën 0 lekë. Shoqëria Albgaz Sh.a. ende nuk po kryen investime në rrjetin e transmetimit. Duke qënë se shoqëria është ende në fazë evidentimi të asetëve të trashëguara, duke vlerësuar linjat e demtuara apo të konsumuara nuk ka ende nje raport final të rrjetit. Paralelisht po kryhen raporte fizibiliteti për shtrirjen e linjave të reja sipas Projektit PIP1, të Gas Masterplan-it. Vetëm në përfundim të kësaj faze të rëndësishme mund të përpilohen projekte investimi të reja. P (provigjone) ende nuk ka të dhëna, sipas shpjegimit të mësipërm. AP (pagesat e marra në avancë si dhe parapagimet nga klientët), është ende 0, duke marrë në konsideratë që kontratat e lidhura me klientët aktual nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që funksionojnë më parapagim të shërbimit të transmetimit. TP (Ilogari të pagueshme mbi të cilat nuk paguhet interes), shoqëria Albgaz ende nuk ka kryer investime në rrjet duke përdorur kredi pa interes. CG (vlera e asetëve të përfituara nëpërmjet dhurimit), gjithashtu është në vlerën 0 Lekë.

Në konkluzion të zbatimit të ekuacionit për të zbuluar bazen e rregulluar të asetëve, RAB, rezulton shuma prej 243,756,181 Lekë. Në vijim duhet përlllogaritur koeficienti WACC në mënyrë që të përcaktojmë kthimin nga kapitali. Sipas kapitullit 9.3 të draft-metodologjisë së ERE sugjerohet një shpërndarje kapitali si 40% kapital i vet dhe 60% kapital hua. Kjo shpërndarje nuk është ende e aplikueshme në kushtet e Albgaz sh.a. Investimet që parashikohen për 2018 janë të orientuar në ngritjen e zyrave të administratës së vendosur në Fier. Ky investim sipas draft-metodologjisë nuk kategorizohet si i nevojshëm për operimin e rrjetit. Investime të tjera të parashikuara në rrjet janë të natyrës së mirëmbajtjes, ku sipas nevojës do të zëvendësohen disa makineri e pajisje, apo remont kapital. Investimi per PIP1 është ende në fazën e studimit, ende nuk është projekt konkret pra nuk është i miratuar nga organet vendimarrëse të Albgaz sh.a..

Në këto kushte, kapitali i Albgaz Sh.a. vazhdon të jetë 100% kapital i vet. Taksat e aplikueshme për kompani të regjistruara si biznes I madh, sic dhe është regjistruar Albgaz Sh.a. janë në masën 15%, dhe sipas sugjerimeve po marrim një normë të pranueshme prej 10% kthim të lejuar për kapitalin e vet (pas taksave).

Perllogaritja e Koeficientit per Kthimin e Kapitalit me 100% Kapital te Vet

$WACC = [ES \cdot AROE / (1-T)] + (DS \cdot COD)$	ES	T	AROE	DS	CoD
0.117647059	100%	15%	10%	-	-

Përlllogaritja e WACC dhe e RAB e bën më të qartë pasqyrën e elementëve të tarifës të paraqitur në fillim të materialit.

$ROC = RAB \cdot WACC = 28,677,197.76$

***ANALIZA E KOSTOVE PER CAKTIMIN E TARIFES SE TRANSMETIMIT TE GAZIT NATYROR**

Elemente kosto	Emertimi		Kosto Operacionale realizim 2017	Kosto Operacionale programim 2018
1	Kosto Page	000/Leke	25,633	39,156
2	Trajtime (+ Antidota)	000/Leke	8,005	10,356
3	Sigurimet shoqerore	000/Leke	4,281	6,427
4	Te tjera konstante	000/Leke		200
5	Projekti per sigurim teknik enesh nen presion	000/Leke	988	
6	Lubrifikant-Karburant	000/Leke	1,733	3,500
7	Energji elektrike	000/Leke	6,865	9,000
8	Shpenz Marteriale + veshje pune	000/Leke	75	5,500
9	Shpen.zhdemtim mjedisi- vl mjedisor	000/Leke		1,800
10	Humbje	000/Leke	79	1,400
C (Elementet e Kostots sipas Nenit 7)		000/Leke	47,659	77,339
D (Amortizimi sipas percaktimit Neni 8)		000/Leke	2,000	11,500
ROC (Kthimi mbi kapitalin sipas Nenit 9)		000/Leke	28,677	28,677
CRI (Te ardhura te zbritshme sipas Nenit 10)		000/Leke	-	-
OCP (Akhustime sipas Nenit 11)		000/Leke	-	19,662
GC = C + D + ROC - CRI + OPC		000/Leke	78,336	137,178
Sasia e Transmetuar (1000 / NM3)			767	3,600
Tarifa e Transmetimit			102	38

Detajimi i të dhënave për Kostot e Pagës

Organigrama e Shoqërisë AlbgaZ Sh.a. si dhe Struktura e Niveleve të Pagës janë aprovuar nga organet vendimarrëse, si Këshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme. Struktura e aprovuar ka 116+1 të punësuar, dhe fondi i shpenzimit të pagave që përfshin edhe trajtimet ushqimore, antidotat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit janë në totalin prej 96'283'000 Lekë. Totalin e shpenzimit të pagave të personave të punësuar si dhe shpenzime të tjera të përfshira në kosto operimi, janë të disponueshme gjithashtu tek Programi I Zhvillimit Ekonomik 2018.

Totali I përfshirë në koston e pagave me qëllim përlllogaritjen e kostove të përgjithshme të operimit të rrjetit është bazuar vetëm në pozicionet e punës që lidhen me operimin e linjave të transmetimit. Përmbledhësen e të dhënave sipas Organigramës së AlbgaZ sh.a për 2018 dhe Strukturës së nivelit të Pagave për 2018, e pasqyron tabela në vijim.

	Niveli 4	Shtesa Ushqimore	Antidota	Nr Punonjesh	Paga	Antidota	Trajtime	Sigurime Shoqërore
Drejtor Teknik	180,000	11,000	500	1	180,000	500	11,000	18,937.50
Përgjegjës sigurim teknik	110,000	11,000	500	2	220,000	1,000	22,000	39,235.00
Përgjegjës transmetim Shperndarje	95,000	11,000	500	1	110,000	1,000	11,000	15,865
Specialist I Mirembajtjes/Sig teknik/Impakt Mjedisor	95,000	11,000	500	2	220,000	1,000	22,000	39,235
Përgjegjës Sektori Sherb Operacionale	110,000	11,000	500	1	110,000	500	11,000	17,747.50
Specialist Sektor Sherb Operac	95,000	11,000	500	2	190,000	1,000	22,000	31,730
Përgjegjës stacioni	50,000	11,000	500	4	200,000	2,000	44,000	33,400
Kipist/Magaziner	42,000	11,000	500	4	168,000	2,000	44,000	28,056
Pastrues	28,000	11,000	500	1	28,000	500	11,000	4,676
Përgjegjës Dispecer	62,000	11,000	500	1	62,000	500	11,000	10,354
Dispecer	34,000	11,000	500	3	102,000	1,500	33,000	17,034
Operator kompresorist saldator axhustator	34,000	11,000	500	17	578,000	8,500	187,000	96,526
nd/operator/mirembajtjes /saldator	32,000	11,000	500	12	384,000	6,000	132,000	64,128
roje tubacioni	31,500	11,000	500	9	283,500	4,500	99,000	47,345

Kontrollor Tubacioni	28,500	11,000	500	15	427,500	7,500	165,000	71,393
Totali Mujor					3,263,000	38,000	825,000	535,661
Te dhenat vjetore (per 12 muaj)					39,156,000	456,000	9,900,000	6,427,932.00

➤ Plani i Investimeve

Plani i investimeve në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Albgaz sh.a. dhe krijimit të një strukture funksionale për operimin e transmetimit të gazit sipas kërkesave është paraqitur sin ë vijim. Mbulimi financiar i tyre është i parashikuar në marrveshjen për ngritjen e kapaciteteve me shoqërisë TAP AG.

i. Investime për Makineri Pajisje

A. Për ngritjen e kapaciteteve teknike: (45 000 € / 6 075 000 ALL)

- Te garantohet literatura didaktike (në variant hardcopy dhe digjital) për rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të kësaj drejtorie si dhe te hartohen hartat e sakta të linjave ekzistuese dhe te te reja.

B. Për krijimin e kushteve bashkekohore: 10 064 000 ALL

- Programe (software) inxhinierik dhe programe për regjistrim e rekordeve të ndryshme apo ndjekjen e ecurisë së projekteve.
- Ploter inxhinierik per formatet A2, A1, A0

C. Për pajimin e personelit për aktivitetin në terren: (110 000 € / 14 850 000 ALL)

Furnizimi me pajisje të nevojshme për kryerjen e detyrave të kësaj drejtorie si:

- Pajisje rievuese (total-station, GNSS, lazermetër, UAV, etj)
- Pajisje matëse (laser-metër, shirit-metër, kaliber, pajisje UT për matje spesori, etj)
- Pajisje inspektuese dhe testuese
- Pajisje për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë (HSE): sinjalizues, pajisje detektuese manuale dhe automatike për rrjedhjen e gazit dhe prezencën e gazrave helmues,etj
- Pajimi PPE, etj
- Riparimi dhe kompletimi i rrjeteve ekzistuese të hidranteve në Ballsh dhe Fier

D. Sipas nevojave të parashikuara nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, 2 automjete pick up, 2 automjete SUV për përdorim nga administrata e Albgaz sh.a. të parashikuara për një vlerë prej 10 000 000 ALL. Vlera e makinerive të remontit parashikohet 2 000 000 ALL.

ii. Projekti për ndërtimin e dy magazinave të reja dhe rikonstruksioni i zyrave në Sheq të Madh

Rikonstruksioni i Zyrave në Sheq të Madh si dhe ndërtimi i dy magazinave të mëdha për vlerën. Projekti i parashikuar fillimisht për vitin 2017 por për shkak se është shtyrë afati i realizimit, përfshihet në projektet e investimit për vitin 2018. Referuar sa më sipër, Albgaz parashikon rehabilitimin e këtyre ambienteve duke përfshirë:

- Rehabilitimin e rruges hyrese dhe sheshit për magazinim

Ky rehabilitim parashikon shtrimin e rruges hyrese me shtresa asfaltike ndërsa sheshin me shtresa betoni të armuar me dopio zgare për perballimin e peshave të konsiderueshme që parashikohet të magazinohen. Gjate këtij rehabilitimi duhet të trajtohet hyrja, rrethimi, dhe parkimi i automjeteve. Kosto paraprake: 7,805,907.59 ALL

- Rikonstruksionin e godines ekzistuese të zyrave

Godina ka nevojë për t'u trajtuar në të gjithë elementet e saj. Parashikohet trajtimi i fasades për termoizolim sa më të mirë dhe hidroizolimi i terraces për të eliminuar lagështinë nga rreshjet. Ambientet do të rikonstruktohen teresisht nga brenda duke ju pershtatur funksioneve të reja si zyra, salla mbledhëse, qendër kontrolli, arkive, etj. Këto punime përfshijnë trajtimin e dyshemese, suvase, dyerve dhe dritareve, rrjeteve dhe instalimeve elektrike dhe hidraulike, etj. Gjithashtu këto ambiente do të pajisen me mobilimin e nevojshëm dhe pajisje të tjera në varesi të funksionit të secilit ambient (poste pune, tryeza mbledhëse, kompjutera, rafta të zakonshme dhe rafta për arkive, kondicionere). Kosto paraprake: 27,758,712.56 ALL

- Ndërtimin nga fillimi të dy magazinave me konstruksion metalik (ambiente magazinuese, ofiçina, zyra, laborator, etj)

Magazinat do të realizohen me struktura metalike dhe veshje të lehtësuara me panele sanduiç. Lartësia e tyre do të shkojë deri në 6m ndërsa hyrjet do të pershtaten me funksionin e secilit ambient. Aty do të akomodohet magazina e pjeseve të kembimit, ofiçina, laborator, zyra ndihmese, njëje sanitare, ambiente për magazinimin

e pajisjeve PPE te stafit, etj, se bashku me pajisjet perkatese per secilin funksion (makinerite e ofiqines dhe mjetet e punes, vinç-ura, pajisjet e laboratorit, raftet magazinuese, mjete transporti, etj). Kosto paraprake: 44,671,331.22 ALL. Për të realizuar punimet e mësipërme, parashikohet shpenzimi i tarifës për shërbime, zë i cili përfshin veprimtaritë si projektim, kolaudim, mbikqyrje, në vlerën totale prej 1,216,120.22 ALL

iii. Investime në Linjat e Tubacioneve

Ndërtim – Montim – Tubacione është zëri që parashikon investimet për zëvendësim tubacionesh në segmentin Drenovë-Ballsh si ndër linjat më aktive por edhe e amortizuar. Vlera i investimit arrin në 17 000 0000 ALL dhe projektet për modernizimin e elementeve të stacioneve në linjë në 1 380 000 ALL. Drejtoria Teknike ka evidentuar linjat më të domosdoshme për të filluar procesin e zëvendësimit të tubacioneve të amortizuara. Prioritet përfaqsojnë linjat si në vijim:

- Zëvendësim Tubacioni D = 8“ dhe L = 20 ml, linja Ballsh – Fier
- Zëvendësim Tubacioni D = 6“ dhe L = 30 ml, linja Ballsh – Fier
- Zëvendësim Tubacioni D = 4“ dhe L = 150 ml, linja Ballsh – Dekantim Kash
- Zëvendësim Tubacioni D = 4“ dhe L = 200 ml, linja Fier – Frakull

Në rast se ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe rehabilituese ne rrjetin ekzistues do te gjykohen nga Albgaz sh.a. të domosdoshme per investim, në alternative ndaj projektit PIP1 të parashikuar nga Gas Masterplani janë sugjeruar nga Drejtoria Teknike dhe Drejtoria e Projekteve dhe Marrveshjeve, në perspektivë për vitin **2019-2020** investimet ne rrjet si më poshtë:

- Rinovimi dhe plotësimi me komponente i linjes Drenove – Ballsh 5.5 km në përputhje me Rregullat e Gazit ne fuqi për Industrinë e Gazit.
 - Rinovimi dhe plotësimi me komponente i linjes Fier – Ballsh 24 km në përputhje me Rregullat e Gazit në fuqi për Industrinë e Gazit.
 - Rehabilitimi, plotësimi me komponente dhe vënia në gjëndje pune e linjez Delvine – Ballsh 101.5 km në përputhje me Rregullat e Gazit në fuqi për Industrinë e Gazit.
 - Rikonstruksion i plotë i stacionit të kompresorëve Drenovë si dhe njërive mbështetëse të këtij stacioni si dhe rivitalizimi i te gjithë separatoreve në përputhje me Rregullat e Gazit në fuqi për Industrinë e Gazit.
 - Riparimi dhe kompletimi i rrjeteve ekzistuese të hidranteve në Ballsh dhe Fier.
- Duhet të paraqiten në mënyrë analitike, të grupuara, llogaritjet e amortizimit për vitin 2017.

➤ **Analiza të llogaritjeve të Amortizimit për vitin 2017.**

Në referim të kërkesës për një pasqyrim më analitik të përlllogaritjeve të amortizimit për vitin 2017 është plotësuar dokumentacioni lidhur me amortizimet sipas rubrikave, shumave të akumuluar të amortizimit si dhe vlerës së amortizimit vjetor për 2017.

Rubrikat dhe postet	SHTESA			PAKESIME			Shuma e akumuluar ne mbyllje te ushtrimit
	Shuma e akumuluar ne celje te ushtrimit	Amortizim Vjetor	Gjithsej	Pakesim nga vlersimi i cdemtimeve	Element te nx. jashte perdorimit	Gjithsej	
Toka terrene	0	0	0				0
Ndertesat	3,336,197	221,875	3,558,073				0
Makineri e pajisje	10,131,960	756,266	10,888,227				0
Ndertim instalim tubac	209,354,226	1,186,582	210,540,808				0
Pajisje zyre	44,505	131,844	176,349				0
							0
SHUMA 1	222,866,889	2,296,568	225,163,456	0	0	0	225,163,456

Krahas rubrikave kemi përcaktuar shumën e akumuluar të amortizimeve ndër vite në momentin e transferuar nga Albpetroli në Albgaz sh.a, shuma është 222 866 889 lekë.

Shuma e amortizimit vjetor për vitin 2017 është 2 296 568 lekë. Theksojme se për tarifën e cmimim është marrë shuma e amortizimit të shtesa e vitit 2017 AAM të marrë falas (pajisje zyre) dhe shuma e akumuluar në mbyllje të vitit ushtrimor pra, më 31 .12.2017 është **225 163 456 lekë**.

Metodat e amortizimit për **ndërtesat**, të cilat u transferuan nga Albpetrol, zbatojnë formulën lineare të vlerës historike (të blerjes ose transferimit) dhe normat amortizuese janë në masën 1.5%.

Për grupin e aseteve "**Makineri dhe Pajisje**" zbatohen me norme amortizimi 2.5%.

Për grupin e aseteve "**Pajisje Zyre dhe Informatike**" zbatohen normat në masën 3%.

Për "**Ndertim-instalime-tubacione**" zbatohen me normë 1.5%.

Në vazhdim, duke iu referuar pasqyrës së Aktiveve Afatgjata për vitin ushtrimor 2017, kemi një vlerë totale asetesh prej 1,065,921,657 ALL.

Amortizimi i akumuluar me 31.12.2017 është 225 163 456 lekë. Nga vlera totale kontabël zbrësim amortizimin e akumuluar në fund të vitit 2017 dhe Vlera kontabel me 31.12.2017 është 840,758,201 lekë.

Pasqyra e Aktiveve Afatgjata per ushtrimin 31.12.2017

Aktive Afatgjata	Vlera kontabel	Shtesat gjate ushtrimit			Rivleresime	Marre falas	Levizje grupi	Te tjera	Shuma e shtesave	
		Kontribute ne kapital	Blere	Krijuar						
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1) Emri i mire	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2) Shpenzimet e zhvillimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3) Te tjera AAJM	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1,050,420,519	0	0	0	0	0	15,500,738	0	0	15,500,738
Toke,terrene	139,570,475	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndertesa	20,664,688	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Makineri e paisje	41,043,347	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndertim Insta tubacio	848,948,477	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Paisje zyre	193,932	0	0	0	0	0	15,500,738	0	0	15,500,738
AFGJ	Pakesimet gjate ushtrimit									31.12.2017
	Shitje	J.perdorimi	Rivleresim	trasferim	pakesime	Levizje grupi	Shuma e paksimeve	Vlera kontabel bruto me 31.12.17	Amortizimi i akumuluar me 31.12.17	Vlera kontabel ne bilanc
	10	11	12	13	14	15	17	18=-(1+10-17)	19	20=-(18-19)
1) Emri i mire	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2) Shpenzimet e zhvillimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3) Te tjera AAJM	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	0	0	1,065,921,657	225,163,456	840,758,201
Toke,terrene	0	0	0	0	0	0	0	139,570,475	0	139,570,475
Ndertesa	0	0	0	0	0	0	0	20,664,688	3,558,073	17,106,615
Makineri e paisje	0	0	0	0	0	0	0	41,043,347	10,888,227	30,155,120
Mjete transporti	0	0	0	0	0	0	0	848,948,477	210,540,808	638,407,669
Paisje zyre	0	0	0	0	0	0	0	15,694,670	176,349	15,518,321
	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	0	0	1,065,921,657	225,163,456	840,758,201

➤ Bashkelidhur tek Bilanci i Vitit 2017 jane pasqyruar tabelat e Amortizimit.Per Vitin 2018 jane parashikuar zevendesime tubacionesh cka sjell dhe rritjen e ndjeshme te amortizimit (tubacionet qe do te zevendosohen do te konsiderohen teresisht te amortizuara).

- Programi i Zhvillimit Ekonomik duhet të dërgohet bashkë me Vendimin mbi miratimin e tij nga Këshilli Mbikqyrës.

➤ Bashkelidhur “Programit të Zhvillimit Ekonomik për Vitin 2018”, Vendimi Nr.27 Datë 27.12.2017 i Këshillit Mbikqyrës “Mbi Miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik për Vitin 2018” të Shoqërisë Albga Sh.a

- Aplikimi duhet të plotësohet me një vlerësim mbi konkurrueshmërinë e çmimeve të gazit për klientët fundorë në zbatim të dispozitës 21.1 të metodologjisë, e cila përcakton se shoqëria duhet të paraqesi një vëzhgim mbi tarifën e rritjes në vendet fqinje.



Konkurrenshëmëria e cmimeve të gazit për klientët fundorë që furnizohen me gaz natyror.

Krahasimi i tarifave të transmetimit në vendet e Ballkanit (përfshirë Ukrainën dhe Moldavinë) sipas kategorive **1.rezidencialë** dhe **2.industrialë**.

Një sërë faktorësh merren në konsideratë kur lexojmë tarifën mesatare përkatëse sipas shteteve dhe kategorive konsumatore:

- Distanca e burimeve të prodhimit të gazit natyror
- Disponueshmëria dhe kapaciteti i tubacioneve të gazsjellësit, duke lidhur burimin, rrjetin e transmetimit dhe hapësirat e depozitimit.
- Volumet dhe karakteristikat e kërkesës së konsumatorëve
- Kostot e transmetimit, tatimet dhe taksa të tjera (licensa, leje mjedisore, etj.)
- Kuadri rregullator
- Disponueshmëria e furnitorëve konkurrues.

Dy janë komponentët bazë që përcaktojnë cmimin e gazit natyror:

- **Kosto e lëndës së parë (Commodity):** Kostoja e vetë gazit natyror, i prodhuar ose i tregtuar si i tillë dhe që përllëgëritet në sajë të vlerës energjetike që emëton, zakonisht në kWh ose metër kub normal. Kosto e gazit të shpenzuar është variabël, dhe përcaktohet sipas profileve konsumatore (industri, biznes apo familje) dhe volumit të shpenzuar për secilin subjekt.

- **Kosto e transmetimit:** Kostoja e transportit të gazit natyror nga burimi i prodhimit, në rrjetet e transmetimit, hapësirave depozituese ose nëpërmjet impianteve të lëngëzimit/rigazifikimit, drejt konsumatorëve.

Me Kosto të transportit të gazit natyror nënkuptojmë tarifën e transmetimit në sensin e ngushtë të fjalës. *Tarifa e kapacitetit* është pikërisht shëmbëllimi final i kostove të transportit të gazit e cila akumulohet përgjatë hallkave të sektorit nga prodhuesi të konsumatori.

Shtetet	Rezidencial (€ cent/Nm ³)	Industrial (€ cent/Nm ³)
Bullgari	34	21
Greqi	70	30
Kroaci	40	30
Rumani	35	28
Sloveni	61	36
Maqedoni	-	23
Serbi	36	32
Bosnje-H.	37	41
Moldavi	32	27
Ukraine	26	25

Tarifa e transmetimit të aplikuar nga ana e shoqërisë Albgaz sh.a përafrohet me nivelet e tarifave analoge në vëndet e Ballkanit. Kujtojmë se tarifa prej 38 lekësh (pa t.v.sh) këmbëhet sipas kursit të datës 30.01.2018, Banka e Shqipërisë; **1 EUR= 133.50 ALL.**

Rrjedhimisht, tarifa e propozuar nga Albgaz sh.a përkon me vlerën 29 EUR Cent për Nm³

Sic mund të krahasojmë nga tabelat e tarifave konkludojmë se tarifa e propozuar për tregun e Shqipërisë është të paktën e konkurrueshme dhe në disa raste më e ulët.

Ndërkohë, po të krahasojmë tarifat e energjive konkurruese (Diagrama 2), konkretisht ato të energjisë elektrike, vërejmë se për të njëjtën vlerë energjetike të konsumuar (ekuivalent i NM³ është 10.83 kWh), tarifa përkatëse varion nga 58 EUR cent për furrat e bukës deri në 113 EUR cent për furrat me kv të ulët. Ndërkohë që për rezidentët aplikon tarifa prej 77 EUR cent për cdo 10.83 kWh të harxhuar. Në oraret e pikut, tarifat pësojnë një rritje të lehtë përveçse për familjarët dhe konsumatorët me intensitet 35 kv.

Diagrama 1: Pasqyrimi i Tarifave të Gazit Natyror për industrinë dhe rezidentët.






Diagrama 2: Pasqyrimi i Tarifave* të Energjisë Elektrike sipas përdoruesve (Këmbyer në € cent).





***Shënim:** Tarifat janë përcaktuar *pa t.v.sh* dhe janë këmbyer në EUR cent.

****Shënim:** Për krahasimin e mësipërm janë përdorur *tarifat normale*. Tarifat e pikut pësojnë një rritje të lehtë.

Me respekt,

Genci GJEÇI
Administrator

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR
ALBGAZ SH.A.



RELACION**MBI****PROJEKT PROGRAMIN E ZHVILLIMIT EKONOMIK PER VITIN 2018**

I nderuar Kryetar;

Të nderuar Anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të Albgaz Sh.A;

Me Vendimin Nr. 848, datë 07.12.2016, për “Krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.A. dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të Shoqërive Albpetrol Sh.A. dhe Albgaz Sh.A.”, Këshilli i Ministrave, ka krijuar autoritetin publik që është përgjegjës për trasmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror ne Republikën e Shqipërisë, e cila është Shoqëria “Albgaz” Sh.A.

Në vijim të kësaj VKM-je, në datë 05.01.2017, aksioneri i vetëm i Shoqërisë “Albgaz” Sh.A., Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka aprovuar statutin e kësaj Shoqërie dhe ka kryer rregjistrimet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas kërkesave të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Shoqëria Albgaz sh.a operon në sektorin e gazit natyror si operator i kombinuar, duke u angazhuar në trasmetimin, shpërndarjen e gazit natyror. Objektivat e shoqërisë janë:

- Furnizimi i klientëve nëpërmjet rrjetit të trasmetim/shpërndarjes sipas kërkesave të volumit, cilësisë dhe specifikave për të garantuar sigurinë e furnizimit, dhe ofrimin e një alternative energjetike kundrejt hidrokarbureve apo hidrocentraleve.
- Përmirësimi, rinovimi dhe zgjerimi i infrastruktures së rrjetit të trasmetim/shpërndarjes në kuadër të politikave kombëtare referuar Ligjit 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe bashkëpunimi i ngushtë me shoqëritë analoge europiane për lidhjen e rrjeteve interkoneksion, për të diversifikuar dhe garantuar furnizimin me energji.

- Ofrimi i shërbimit të transmetimit, shpërndarjes, depozitimit dhe impianteve të gazit ndërmerret në bazë të parimeve të: efciences në kosto, cmimeve konkurruese, transparente dhe jo-diskriminuese dhe impaktit të ulët mjedisor.

Në zbatim të Udhëzimit Nr.394 Datë 21.08.2014 “Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive Tregëtare me Kapital Shtetëror”, shoqëria Albgaz Sh.A. ka hartuar Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018. Programi i Zhvillimit Ekonomik i vitit 2017 u bazua në ecurinë e sektorit të gazit si një pjesë integrale e Albpetrol sh.a., ndërkohë që ecuria teknike, ekonomike dhe tregëtare tashmë kanë një identitet më të formëzuar por ende në zhvillim e sipër. Viti 2017 evidentoi faktin që sektori i gazit në Shqipëri, me infrastrukturë të ngritur që prej vitit 1971 ka nevojë për mirëmbajtje dhe investime të vazhdueshme në mënyrë që të minimizohen humbjet e gazit dhe të kryhet aktiviteti parësor i transmetimit dhe shpërndarjes të gazit natyror.

Misioni i shoqërisë Albgaz sh.a. është të transmetojë dhe shpërndajë gaz natyror te konsumatori, sipas sasisë dhe specifikave të kontraktuara, me efciencë, efektivitet afatgjatë dhe profesionalizëm. Misioni mbështetet te Ligji 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” ku synohet furnizimi me gaz natyror pa ndërprerje, me cmime jo-diskriminuese dhe ku çdo palë e tretë e interesuar ka të drejtën për akses. Perspektiva për vitin 2018 është e lidhur me krijimin e marrveshjeve të reja e të qëndrueshme tregëtare. Krijimi i këtyre marrveshjeve do të kushtëzojë projektet inxhinierike për të krijuar linja të reja për transmetimin e gazit në drejtim të klientëve

Aktiviteti i operatorit të kombinuar Albgaz sh.a ushtrohet me anë të licensës së lëshuar nga Enti Rregullator i Energjisë. Në përputhje me licensën shoqëria ka të drejten dhe/ose detyrimin të ndërtojë, zotërojë, operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë një system të sigurt nga rreziqet dhe eficient të transmetimit të gazit natyror në një treg të udhëhequr nga konkurrenca si edhe kapacitete të mjaftueshme për të plotësuar kërkesën e arsyeshme të gazit natyror në një territor të caktuar dhe që me anë të kapitalit fizik, financiar dhe intelektual të përmbushi detyrimet e shërbimit.

Infrastruktura e sistemit të gazsjellësit në vënd është pjesërisht e amortizuar dhe daton e prodhimit të viteve 70', teknologjia e së cilës origjinon nga Zvicra. Një rinovim tërësor i infrastrukturës së gazsjellësit pritet të realizohet në kuadër të investimeve strategjike me rëndësi kombëtare (Gas Masterplani), ku gazsjellësi TAP AG do të ketë rol suportues në konceptimin, planifikimin dhe implementimin e projektit.


1. Të Ardhurat e Shoqërisë

Shoqëria Albgaz sh.a do të synojë të furnizojë me gaz natyror nëpërmjet transmetimit/shpërndarjes fabrikat e industrisë së rëndë të angazhuara në metalurgji, cemento dhe produkte të tjera gurorë. Konsumi rezidencial është pothuajse i papërfillshëm, por me rinovimin e infrastrukturës dhe në varësi të implementimit të projektit prioritar në Vlorë, pritet një zgjerim i tregut të furnizimit me gaz natyror, duke i dhënë mundësi për akses bizneseve dhe rezidentëve. Duhet të ritheksojmë se Albgaz është i vetmi operator i kombinuar (transmetim e shpërndarje) aktiv në sektorin e gazit natyror, prandaj pozicioni i një monopoli natyral evidentohet kështu.

Strategjia e segmentimit të tregut është relativisht e drejtpërdrejt në rastin tonë. Gas Masterplani për sektorin e gazit natyror në Shqipëri do jetë përgjegjës për zhvillimin e strategjisë së energjetikës, duke ofruar një alternativë reale të furnizimit me energji kundrejt burimeve tradicionale, të tejkaluar nga kërkesa vëndase, dhe që varen gjithnjë e në rritje nga importi i energjisë nga jashtë, gjë e cila sjell kosto të larta në afatgjatë. Projekti me prioritet PIP Vlorë, synon të plotësojë kërkesën për energji, në mënyrë konstante, efiçiente dhe të sigurt të zonës përreth ku përfshihen zona industriale Fier-Vlorë, bizneset e këtyre qyteteve dhe pjesa e popullsisë e cila do të ndërrojë/shtojë platformën e furnizimit me energji.

Vëllimi i transmetimit i parashikuar për 2018 është në nivelin 3 611 000 Nm³. Përcaktimi i tarifës së përkohshme të transmetimit e përcaktuar nga ERE sipas Vendimit Nr. 90, Datë 07.06.2017 "Mbi Miratimin e Tarifës së Përkohshme të Transmetimit të Gazit Natyror nga Shoqëria Albgaz Sh.A. për Periudhën 05.01.2017-20.09.2017" është apeluar nga Shoqëria duke arsyetuar se cmimi i vendosur prej 25 lekë/m³ pa TVSh e përfshirë, është tepër e ulët në krahasim me tarifën e kërkuar prej 40 lekë/ Nm³. Ndërkohë ERE nuk ka aprovuar ende tarifën e distribuimit të gazit. Tarifa e përkohshme ka afat datën 20 Shtator 2017, dhe për të përcaktuar tarifën e re do të fillojnë seancat e reja dëgjimore ku do të shqyrtohen mundësitë për vendosjen e tarifës së transmetimit si dhe shpërndarjes. Në vijim paraqitet në tabelë sasia mujore e gazit të transmetuar në linjat e Albgaz sh.a., pa përfshirë humbjet në rrjet.

Sasia e Transmetuar e Gazit drejt Albpetrol sh.a



Sipas Vendimit të ERE Nr 142, datë 06.09.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së Gazit Natyror”, tarifa për të cilën shoqëria Albgaz Sh.A. do të negociojë gjatë seancave dëgjimore tek ERE do të jetë përsëri 40 lekë/ Nm3. Në përputhje me termat e parashikuara në metodologji, kostot e përgjithshme të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes janë si në tabelën në vijim ku dhe përcaktohet tarifa e transmetimit/shpërndarjes. FCRT (Full Cost Recovery Tariff) do të jetë instrumenti i pikënisjes së metodologjisë së tarifës, e cila do të përcaktojë fitimin e lejuar të shoqërisë gjatë vitit kontabël. Fitimi i lejuar sipas metodologjisë është 10% mbi rezultatin e të ardhurave të përfituara nga transmetimi/shpërndarja, zbritur kostot e përgjithshme të transmetimit. Në metodologji shpenzimet administrative të Shoqërisë Albgaz sh.a. nuk përfshihen në ekuacion. Kostot e përgjithshme të rrjetit llogariten si në vijim : **GC = C + D + ROC – CRI + OCP**

Ku:

GC – Kostot vjetore të Rrjetit

C – Elementët e Kostos

D – Amortizimi

ROC – Kthimi mbi kapitalin me supozimin që kapitali është i shpërndarë sipas struktues 40% Kapital i vet dhe 60% Hua me Interes.

CRI – Të ardhura të Zbritshme

OPC – Axhustime të periudhave të ndryshme

*ANALIZA E KOSTOVE PER CAKTIMIN E TARIFES SE TRANSMETIMIT DHE SHPERNDARJES TE GAZIT NATYROR

Emertimi		Kosto Operacionale 2018	
1	Kosto Page	000/Leke	45,757
2	Trajtime	000/Leke	3,000
3	Sigurimet shoqerore	000/Leke	7,641
4	Te tjera konstante	000/Leke	200
5	Lubrifikant - Karburant	000/Leke	3,500
6	Energji elektrike	000/Leke	9,000
7	Shpenz Marteriale - veshje pune	000/Leke	5,500
8	Shpenz zhdemtim mjedisi - vl mjedisor	000/Leke	1,800
9	Humbje	000/Leke	1,400
	C (Nentotal -Elementet e Kostots sipas Nenit 7)	000/Leke	77,798
	D (Amortizimi sipas percaktimit Neni 8)	000/Leke	11,500
	ROC (Kthimi mbi kapitalin sipas Nenit 9)	000/Leke	55,142
	CRI (Te ardhura te zbritshme sipas Nenit 10)	000/Leke	-
	OPC (Akhustime sipas Nenit 11)	000/Leke	-
	GC = C + D + ROC - CRI + OPC	000/Leke	144,440
	Sasia e Transmetuar (000 / NM3)		3,611
	Tarifa e Transmetimit		40

Duke marrë në konsideratë cmimin e transmetimit 40 lekë/ Nm3, të ardhurat e Shoqërisë nga transmetimi i gazit në drejtim të klientit Albpetrol sh.a. janë në vlerën 116'440'000 ALL. Negociata për klientelë të tjerë në fushën e energjitikës si psh Phoneix Petroleum sha; e cila përmes shkresës me Nr Ref. 139/09/17ALBG me datë 19.09.2017 kërkon bashkëpunimin për transmetimin e mesatarisht 2000 Nm3 në ditë të gazit natyror në burimin e Frakullës. Të ardhurat mesatare vjetore që rrjedhin nga ky bashkëpunim janë në shumën 28 000 000 ALL.

Një burim likujditeti vec të ardhurave bazë të Shoqërisë lidhen me marrveshjen mes TAP AG dhe Ministrisë së Energjitikës dhe Industrisë, TAP AG ka pranuar të ndihmojë Shoqërinë duke paracaktuar një fond prej 700 000 Euro për trajnim stafi ne total, si dhe për ngritjen e kapacitetit nëpërmjet një kredie të butë sipas VKM 233 datë 21.03.2017 “Për miratimin e Marrveshjes së Angazhimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit dhe Marrveshjes për Përfitimet Vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans-Adriatik”. Mbulimi i investimeve për ngritje kapaciteti është qëllimi i kësaj marrveshje, dhe për vitin e ardhshëm parashikohet të jetë në shumën barazvlefshme me investimet e aprovuara si në vijim të relacionit.

Shoqëria Albgaz sh.a. ka nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi me kompanitë homologe të Italisë (Snam s.r.l), Spanjës (Enagas) dhe Greqisë (Desfa), Holandës (Gasunie) si dhe është pjesë e një bashkëpunimi të ngushtë me kompaninë TAP AG, e cila në kuadër të projektit TAP, është zotuar të përkrahi dhe financojë ringritjen e infrastrukturës së transmetimit të gazit natyror në vendndodhjet ekzistuese në Shqipëri. Në kuadër të marrëveshjes me TAP AG për operimin dhe mirëmbajtjen e gazsjellësit TAP, kompania Albgaz sh.a është angazhuar në një aktivitet tregtar të shtuar që zgjeron kapacitetin dhe aftësitë e firmës në këtë sektor. Programi i mirëmbajtjes dhe operimit të gazsjellësit në territorin e Shqipërisë nënkupton trajnimin dhe kualifikimin e një stafi të përzgjedhur dhe nëpërmjet një bashkëpunimi Joint-Venture, të kryejë aktivitetet e kontraktuara nga TAP AG. Marrëveshja për O&M mbështetet nga marrëveshja e nënshkruar midis TAP AG dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave.


Negociatat më të rëndësishme për Albgaz Sh.A. lidhet me marrjen në dorëzim të kryerjes së shërbimit të mirëmbajtjes për linjat e shtruara të projektit të TAP-it në Shqipëri. Kjo do të sigurojë të ardhura të rregullta dhe të pavarura nga kërkesat për gaz ne treg. Mirëmbajtja e linjave të TAP në territorin Shqipëtar është një temë në negociata e sipër. Në këtë fazë vendimtare të shoqërisë Albgaz sh.a. investimet për rrjetin janë celësi për të ardhmen e shoqërisë. Transmetimi i gazit drejt klientëve kërkon ristrukturim dhe ofrimin e shërbimit pa problematikat aktuale me avari të shpeshta dhe humbjet në rrjet. Nëpërmjet të ardhurave nga fondi i TAP AG do të bëhet e mundur transmetimi i gazit dhe vijueshmëria e punës në cilësinë e duhur.

2. Shpenzimet

Shpenzimet në Programin e Zhvillimit Ekonomik janë të ndara në dy nënkategori, Shpenzimet Variabël dhe Shpenzimet Konstante. Organigrama e Shoqërisë është e pandryshuar, me një numër total punonjësish prej 117 veta me pagë mesatare prej 56 695 ALL. Sipas organikës në të njëjtën linjë me 2017, në vitin 2018 Shoqëria do të operojë përmes strukturës si në vijim: Drejtoria Teknike, Drejtoria e Projekteve dhe Marrveshjeve, Drejtoria e Financës Kontabilitetit dhe Programimit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, dhe Drejtoria e Marrveshjeve Tregëtare.


Aktiviteti i Shoqërisë AlbgaZ sh.a. për vitin 2017 Shpërndarja e shpenzimeve totale për vitin 2017 është paraqitur në diagramën sin ë vijim.

Shpërndarja e Shpenzimeve Faktike për vitin 2017



- Shoëni neto deri bigat
- Shoëni me shërbime K. Mbrojtjes
- Shoëni me shërbime materiale dhe shërbime
- Shërbime nga të tjerë
- Shoëni me Administrative
- Sigurimet shoqërore (16.7%)
- Amortisimi
- Energjia elektrike
- *Shoëni Zhdëmi Rregull Pastr.Mjedis
- Humbje (+Gaz+Interes)

Realizimi i Shpenzimeve perkundiejt Parashikimit per 2017



Bazuar në negociatat e fundit me TAP AG dhe projektin e IAP-it, trajnimi i stafit të Drejtorisë Teknike dhe Sektorit të Projekteve do të jetë ndër pikat kyce të vitit të ardhshëm. Sistemi i linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Shqipëri është ende në proces evidentimi, pasi linjat e vjetra janë administruar dhe mirëmbajtur jashtë standarteve. Kjo sjell nevojën e investimeve në terren, por edhe paraqet një shpenzim për humbje konstante në rrjetin e transmetimit. Sasia e gazit në hyrje të linjave nuk është e njëjtë me atë në dalje dhe kjo paraqet sfidën primare të Shoqërisë, një sistem funksional transmetimi gazi në tregun Shqiptar.


